



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PËRMET
DREJTORIA E PROJEKTEVE TË HUAJA, INTEGRIMIT EVROPIAN, PERFORMANCËS DHE
DIXHITALIZIMIT TË TË DHËNAVE

Nr. 1529 Prot

Përmet, më 13.05.2025

Lënda: Njoftim për rekrutim stafi në kuadër të zbatimit të projektit “Përqaftimi i shpresës, një oaz për ata që kanë nevojë”

ZYRËS VENDORE PËR PUNËSIM DHE AFTËSI PËRMET

NJOFTIM

PËR REKRUTIMIN E STAFIT KOORDINATOR PROJEKTI NË KUADËR TË IMPLEMENTIMIT TË PROJEKTIT “PËRQAFIMI I SHPRESËS, NJË OAZ PËR ATA QË KANË NEVOJË”

Bazuar në Ligjin Nr. 139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, Ligjin Nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, Ligjin Nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, VKB Nr. 107 datë 18.12.2024 “Për buxhetin e Bashkisë Përmet për vitin 2025”, VKB Nr. 79 datë 23.10.2024 “Për miratimin e Planit Social 2024-2027 për Bashkinë Përmet, Marrëveshjen Nr. 72 Prot datë 13.01.2024, midis Shërbimit Social Shtetëror dhe Bashkisë Përmet, në zbatim të projektit «Përqaftimi i shpresës, një oaz për ata që kanë nevojë», Shkresës nga Shërbimi Social Shtetëror Nr. 697 Prot datë 10.03.2025, Bashkia Përmet kërkon të rekrutojë staf për zbatimin e projektit si më poshtë:

Nr.	Pozicioni	Angazhimi
1	Koordinator	1 (31 muaj)

I. Personat e interesuar, duhet të paraqesin pranë autoritetit kontraktues dokumentacionin e kërkuar si dhe të plotësojnë kriteret si mëposhtë:

1. Kriteret që duhet të plotësojë Koordinatori janë:

- Të jetë shtetas shqiptar;
- Të ketë arsim të mesëm;
- Të ketë eksperiencë pune;

Përshkrimi i punës:

- Koordinatori duhet të ndjekë të gjithë menaxhimin, mbarëvajtjen e punës si dhe koordinimin me strukturën e Shërbimit social në Bashkinë Përmet duke referuar dhe raportuar cdo situatë gjatë zbatimit të projektit për një periudhë 31 muaj.
- Koordinatori do të kujdeset për mbarëvajtjen e aktiviteteve të Qendrës Ditore për të moshuarit, organizimin e aktiviteteve sipas planit të aktiviteteve të projektit.

3. Dokumenton zbatimimin e aktiviteteve në kohë dhe i raporton Drejtorisë së Shërbimit Social në Bashki.
4. Harton dhe dorëzon në drejtori gjithë procesin e punës së kryer nga ana e tij në lidhje me këtë pozicion.

Ky pozicion do të trajtohet me pagë bruto 43 000 lekë/muaj.

Dokumentacioni kërkuar:

Kandidatët duhet të dorëzojnë dokumentet si më poshtë:

- 1- Jetëshkrimi i aplikantit CV;
- 2- Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
- 3- Certifikatë familjare;
- 4- Diplomë e arsimit të mesëm e noterizuar;
- 5- Vërtetim si punëkërkuar i papunë;
- 6- Vërtetim i Gjendjes Gjyqësore;
- 7- Vërtetim Gjykatë;
- 8- Vërtetim Prokurorie;
- 9- Librezë pune;
- 10- Librezë mjekësore;
- 11- Certifikime, kualifikime nëse disponohet;

Personat e interesuar mund të kërkojnë informacion për procedurën konkurruese, pranë Bashkisë Përmet.

Dokumentacioni duhet të dorëzohet pranë Zyrës së Protokollit në Bashkinë Përmet, brenda datës 23.05.2025.

Konceptoi: Drejtoria e Projekteve
Klaudja Ciko



KRYETAR I BASHKISË

Alma HOXHA

